

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT



TEMA - MASTER

**NDËRLIDHJA E KUALITETIT TË MËNYRËS SË JETESËS ME
INDEKSIN E MASËS TRUPORE TEK NXËNËSIT E MOSHAVE 14-15
VJEÇ DHE DALLIMET NDËRMJET KOMUNËS SË DEÇANIT DHE
PEJËS**

Mentori:
Prof. Dr. Bujar TURJAKA

Kandidatja:
Rijeta HAKLAJ

Prishtinë, 2021

PËRMBAJTJA

ABSTRAKTI.....	4
ABSTRACT.....	5
1. HYRJE.....	6
2. QËLLIMI I PUNIMIT	8
3. PASQYRA E DISA HULUMTIMEVE TË DERITANISHME.....	9
3.1. Ndikimi i frekuencave të shujtave ushqimore në shëndet	12
3.2. Zgjedhjet e shëndetshme dhe aktiviteti fizik	13
4. HIPOTEZAT THEMELORE.....	14
5. METODAT E PUNËS	14
5.1 Mostra e të anketuarve.....	15
5.2 Mostra e variablave	15
5.3 Metodatat e përpunimit të rezultateve	15
6. ANALIZA DHE DISKUTIMI I REZULTATEVE.....	16
6.1. Interpretimi i parametrave themelor statistikor në bazë gjinie	16
6.2. Interpretimi i parametrave themelor statistikor sipas qytetit	31
7. DALLIMET NË MES TË GJINIVE.....	49
8. DALLIMET NË MES TË QYTETEVE	53
9. NDËRLIDHJET-KORELACIONET	56
9.1 Korelacionet ndërmjet variablave për komunën e Deçanit	56
9.2 Korelacionet ndërmjet variablave për komunën e Pejës.....	58
10. KATEGORITË E INDEKSIT TË MASËS TRUPORE DHE NDRYSHIMET NDËRMJET KOMUNAVE	61
11. VËRTETIMI I HPOTEZAVE.....	63
12. PËRFUNDIMI.....	64
13. LITERATURA	65
SHTOJCË.....	66

ABSTRAKTI

Adoleshenca është periudhë kritike e zhvillimit të mbipeshës. Kultura e pjesëmarrjes në aktivitete fizike dhe e ushqyerjes vendosen që në moshë të hershme, duke vazhduar edhe në periudhat e mëvonshme jetësore. Kështu që përmes pyetësorit kuptojmë rreth angazhimit të të rinjëve të moshave 14-15 vjeç në komunën e Deçanit dhe Pejës në aktivitetet rekreative-sportive, preferencat e tyre në lidhje me sportin dhe se sa ndikon pjesëmarrja në ato aktivitete në mbajtjen e vlerave të duhura të BMI-së.

Variablat e aplikuara për hulumtimin janë pyetjet në lidhje me se sa nxënësit janë aktiv fizikisht, pesha dhe lartësia trupore, si dhe indeksi i masës trupore. Rezultatet janë përpunuar me SPSS, program për përpunimin e të dhënave statistikore.

Fjalët kyçe: BMI, aktiviteti fizik, adoleshentët, sporti, pyetësori.

ABSTRACT

Adolescence is a critical period of overweight development. The culture of participating in physical activity and nutrition is established from an early age, continuing into later life periods. So through the questionnaire we understand about the engagement of young people aged 14-15 in the municipality of Deçan and Peja in recreational-sports activities, their preferences related to sports and how much the participation in those activities affects the maintenance of proper values of BMI.

The variables applied to the research are questions about how active the students are, body weight and height, and body mass index. The results were processed with SPSS, a program for processing statistical data.

Keywords: BMI, physical activity, adolescents, sports, questionnaire.

1. HYRJJE

Që në fillimet e njerëzimit ekziston thënia "Vrapo për jetën tënde!". Zhvillimi fizik ndoqi një rrugë natyrore që përcaktohej nga kërkesat praktike të jetës në një peizazh të egër si dhe nevoja jetësore për të shmangur kërcënimet dhe për të kapur mundësitë për mbijetesë. Kërkesat e lëvizjes konsistojnë në manipulim të mjeteve dhe objekteve natyrore (shkëmbinj, trupa pemësh etj.) për mbrojtje të vetës dhe anëtarëve të tjerë të grupit. Për të mbijetuar në një mjedis të ashpër, plot me pengesa dhe armiq natyral dhe njerëzorë, njeriu i hershëm duhej të dinte jo vetëm se si të vraponte, por edhe të ecte, të ekuilibronte, të hidhej, të zvarritej, të ngjitej, të ngrinte, të mbante, të hidhte e të kapte gjëra dhe të luftonte. Kështu ndër vite lëvizja siguronte edhe përgatitjet për luftë.

Në ditët e sotme çdo herë e më shumë po paraqiten sëmundje nga më të ndryshmet tek moshat e reja, gjë që më parë prania e tyre ka qenë më e rrallë pothuajse e papranishme. Si rezultat i kësaj është mosaktiviteti fizik i të rinjëve dhe jo vetëm.

Si një nga komponentët kryesorë për një jetë të shëndetshme aktiviteti fizik përfshin të gjitha lëvizjet të cilat bëjnë që të shpenzohet më shumë energji se sa kur jemi në gjendje pushimi. Aktiviteti fizik përfshin: ecjen, punët e shtëpisë, punët në kopësht, ecje në shkalle, larjen e veturës, larjen e dritareve etj.

Aktiviteti fizik ndihmon fëmijët dhe adoleshentët të rrisin forcën muskulore, të përmirësojnë aftësinë për kryerjen e lëvizjeve ose detyrave komplekse, të ndërtojnë eshtra të forta, parandalojnë deformitetet e ndryshme që janë të pranishme në moshat përkatëse, poashtu përveç përfitimeve shëndetsore fizike, aktiviteti fizik ndihmon edhe në përmirësimin e gjendjes shpirtërore dhe të rrisë kapacitetin e mushkërive dhe zemrës. Mund të sigurojë edhe parandalim të sëmundjeve siç janë: diabeti i tipit 2, astma, problemeve me gjumin dhe stresin.

Aktiviteti fizik çon në funksionim më të mirë të trurit, përmirëson të menduarit, përqendrimin, kujtesën etj.

Aktiviteti fizik jep mundësi për tu argëtuar, të jeni me miqtë dhe familjen dhe të përmirësoni aftësitë për të marrë pjesë në aktivitete fizike më intensive ose në ngjarje sportive. Po ashtu, mund të përmirësoj aftësitë sociale që mund të rezultojnë në rezultatet akademike: fëmijët mësojnë të

bashkëpunojnë dhe të respektojnë rregullat dhe kështu të ndihen më të lidhur me shkollën dhe komunitetin. Gjithashtu mundëson për të shijuar aktivitetet në mjedise shoqërore, përmirëson cilësinë e gjumit, zvogëlon ndjenjën e mungesës së energjisë, ju ndihmon të jeni më fleksibil, rrit relaksim, mundëson rritje dhe zhvillim të shëndetshëm.

“Sjellja e të qëndruarit” do të thotë shpenzimi i kohës duke bërë shumë pak aktivitet fizik, duke qëndruar ulur para kompjuterit, duke luajtur video lojëra apo duke shikuar televizor. Fëmijët dhe të rinjtë duhet të shpenzojnë shumë më pak kohë në këto aktivitete dhe më shumë kohë në të qenurit aktiv. Që aktiviteti fizik të bëhet më atraktiv e rëndësishme është që aktiviteti të përshtatet me moshën. Nuk është patjetër që të jemi garues në ndonjë sport të caktuar, thjeshtë të jemi aktiv në kohën e lirë, të jemi produktiv duke investuar në veten tonë. Duke qenë një aktivitet vullnetar, ai nuk ka parametra të ngurtë që kufizojnë ushtrimin e tij të lirë gjatë kohës së lirë. Argëtimi mund të ketë një ndikim pozitiv në zhvillimin krijues gjatë aktiviteteve që stimulojnë aftësitë dhe kapacitetet.

2. QËLLIMI I PUNIMIT

Inaktiviteti fizik ka bërë që të rritet shtimi i peshës jo të shëndetshme. Shumë fëmijë dhe adoleshent kalojnë orët e tyre të para pas zgjimit nga gjumi në gjëra që nuk përfshijnë aktivitet fizik, duke u privuar nga përfitimet shëndetsore të lëvizjes, lojës dhe sporteve.

Qëllimi i këtij punimi është të mësojë rreth mënyrës se si nxënësit e moshës 14-15 vjeç e shpenzojnë kohën e tyre dhe efekti i këtyre aktiviteteve në indeksin e masës trupore (BMI).

Poashtu qëllim tjetër i punimit është që përmes pyetësorit të marrim informata se me cilat aktivitete merren këta të rinjë dhe kohën e shpenzuar nëpër këto aktivitete.

Ndër qëllimet e tjera të punimit është edhe krahasimi i vlerave të indeksit të masës trupore prej rezultateve të nxjerrura në mes të dy komunave me infrastruktura të ndryshme zhvillimore.

Qëllimi teorik i këtij punimi është të tregojë se nxënësit që janë të angazhuar në aktivitete fizike kanë njohuri më të mëdha për rëndësinë e aktivitetit fizik në shëndetin e tyre, se sa nxënësit që nuk janë të përfshirë në aktivitete të tilla.

Qëllimi praktik është që në bazë të rezultateve, të rinjët të inkurajohen të marrin pjesë në aktivitete fizike dhe sportive.

3. PASQYRA E DISA HULUMTIMEVE TË DERITANISHME

Dihet se aktiviteti fizik është produkt i nevojës së shoqërisë, sidomos në ditët e stome kur teknologjia është në kulmin e zhvillimit të saj, e kjo jo vetëm që ka ndikuar tek moshat madhore por edhe tek të rinjtë si përdorues të rregullt dhe të tepruar. Kjo sigurisht që ndikon në mirëqenien e tyre të përgjithme. Shumica e dukurive negative janë rezultat i lëvizjes së pamjaftueshme, ngarkesave psikike dhe ushqimit të tepruar, e rezultat i kësaj sigurisht që është inaktiviteti fizik.

Të qenit aktiv fizikisht është e rëndësishme në cdo periudhë të jetës, mirëpo e rëndësishme është sidomos në moshat kur kemi rritje të shpejtuar, për arsye të krijimit të themeleve të mira të formimit të mëvonshëm të njeriut. Në moshën e mesme shkollore (14-15vjet) kemi disproporcion të zhvillimit të eshtrave në gjatësi, masës muskulore dhe indit dhjamor, 15-20% e lartësisë trupore së përgjithshme arrihet në adoleshencë. Marrja e tepërt e kalorive dhe mos aktiviteti fizik paraqet problemet më të theksuara shëndetsore (Bujar Turjaka). Aktiviteti fizik i rregullt jo vetëm që është esencial për rritje dhe zhvillim normal, por gjithashtu stili aktiv i jetesës në pikëpamje fizike gjatë viteve të fëmijërisë mund të ndihmojë në zvogëlimin e rrezikut të zhvillimit të disa sëmundjeve më vonë gjatë jetës (Andersen et al, 2011).


Indeksi i Masës Trupore (BMI) është pesha e një personi në kilogram e ndarë nga katrori i lartësisë në metra. Një BMI e lartë mund të jetë tregues i dhjamosjes së lartë të trupit. Mjeti më i zakonshëm i përdorur për të ndërlidhur rrezikun e problemeve shëndetësore me peshën në nivelin e popullatës. BMI mund të përdoret për të kontrolluar kategoritë e peshës që mund të çojnë në probleme shëndetësore, por nuk është diagnostikuese e dhjamtjes së trupit ose shëndetit të një individi. BMI është një rregull i përshtatshëm, i përdorur për të kategorizuar gjerësisht një person si nënpeshë, peshë normale, mbipeshë ose i trashë në bazë të masës indore (muskujve, dhjamt dhe kockave) dhe lartësisë. Diapazonet e pranuar zakonisht nga BMI janë nënpeshë (<18.5 kg/m²), pesha normale (18.5-25), konsiderohet të jetë mbipeshë (25-30) dhe obeziteti (>30). Kur përdoret për të parashikuar shëndetin e një individi, BMI ka kufizime që mund ta bëjnë atë më pak të dobishëm, veçanërisht kur zbatohet për individ me dhjam në regjion të barkut, shtatshkurtër ose masë muskulore jashtëzakonisht të lartë.

Tek të rinjët vlejnë rregulla të tjera rreth indeksit të masës trupore, interpretohet ndryshe në raport më moshën dhe gjininë. BMI tek adoleshëntët nuk është tregues i drejtpërdrejtë i dhjavit në trup.

Adoleshentët mund të kenë një BMI të lartë nëse kanë një kornizë të madhe ose shumë muskuj, jo dhjam të tepërt. Dhe një person me një kornizë të vogël mund të ketë një BMI normale, por përsëri mund të ketë shumë dhjam në trup (Prevention, Centers for Disease Control and, 2019).

Kategoritë që përshkruajnë peshën e një personi janë:

- Nëneshë: BMI është nën 5%
- Peshë e shëndetshme (adekuate) BMI është e barabartë ose më e madhe se 5% dhe më e vogël se 85%
- Mbipesha: BMI është nga 85% ose mbi të, por më pak se 95%
- Obez: BMI është nga 95% ose më shumë.



The image shows a web-based BMI calculator interface. At the top, there is a dark blue header with the text "BMI Calculator for Child and Teen". Below the header, there are two radio buttons for language selection: "English" (unselected) and "Metric" (selected). Underneath, there are two radio buttons for input type: "Age: Years, Months" (unselected) and "Date of Birth, Date of Measurement" (selected). The "Date of Birth" section includes three dropdown menus for "Month", "Day", and "Year". The "Date of Measurement" section also includes three dropdown menus for "Month", "Day", and "Year". Below this, there is a "Sex:" label with two radio buttons: "Boy" (unselected) and "Girl" (unselected). The "Height (decimal places allowed):" section has a text input field followed by "cm". The "Weight (decimal places allowed):" section has a text input field followed by "kg". At the bottom of the form is a blue "Calculate" button.

Fig.1. Kalkulatori për gjetjen e Indeksit të masës trupore tek fëmijët dhe adoleshentët

Formula metrike për të llogaritur BMI është $\text{pesha} \div (\text{lartësia} \times \text{lartësia}) \times 10,000$.

Për të llogaritur këtë:

- Matni peshën e fëmijës në kilogram (jo gram). Kjo mund të shprehet në një vlerë dhjetore, siç janë 12.7 kilogramë.
- Matni lartësinë e fëmijës në centimetra (jo metra). Kjo do të shprehej, për shembull, si 105 centimetra dhe jo 1.05 metra.
- Llogaritni BMI duke pjesëtuar peshën me lartësinë në katror dhe shumëzuar atë total me 10,000.

Ose, për thjeshtimin e procesit përdoret kalkulatori për gjetjen e BMI-së.

Studimet në Britani nga viti 2013 kanë treguar se femrat midis moshës 12 dhe 16 kishin një BMI më të lartë se meshkujt e së njëjtës moshë me 1.0 kg/m² mesatarisht. 1.9 milion vdekje në të gjithë botën i atribuohen pasivitetit fizik dhe të paktën 2.6 milion vdekje janë rezultat i mbipeshës ose të qenit obez (OBSH, 2013).

Rreth 30% e fëmijëve të plotë do të jenë të tillë deri në fund të jetës dhe 60% e adoleshentëve të plotë mbesin të plotë deri në fund të jetës (Bujar Turjaka).

Studimet e JN Morris and RS Paffenberger e bëra në të gjitha grupmoshat thanë se edhe nivelet e moderuara të aktivitetit fizik ofrojnë përfitime të konsiderueshme shëndetësore, duke përfshirë prevalencën më të ulët të mbipeshës dhe obezitetit (Marcela González-Gross, Agustín Meléndez, 2013). Mbipesha e fëmijëve është njohur si një pandemi globale. Strategjitë parandaluese janë provuar të jenë ndërhyrja më efektive e shëndetit publik në frenimin e kësaj pandemie. Një qasje me shumë përbërës që përfshin modifikimin e dietës për një mënyrë jetese të shëndetshme që përfshin një aktivitet të rregullt fizik, duke minimizuar kohën e ekranit dhe ndërhyrjet e sjelljes janë gjetur të dobishme në parandalimin e mbipeshës. Është rekomanduar një qasje e ciklit jetësor kur ndërhyrjet parandaluese shkojnë aq larg sa ndikojnë në ushqimin dhe mënyrën e jetesës së nënës, fetusit dhe fëmijërisë së hershme. Përfshirja e familjes, shkollës dhe komunitetit është e rëndësishme për rezultatet afatgjata, po kështu është edhe përfshirja e qeverisë në zhvillimin e politikave që ndihmojnë në krijimin e një ambienti dhe mundësive për dietë të shëndetshme dhe aktivitet fizik. Menaxhimi i mbipeshës në fëmijëri është sfidues. Barnat kundër mbipeshës kanë një rol të kufizuar në vitet e fëmijërisë dhe nuk rekomandohen tek fëmijët. Kirurgjia Bariatrike

(Bypasi gastrik dhe operacionet e tjera të humbjes së peshës - të njohura kolektivisht si kirurgji bariatrike - përfshijnë bërjen e ndryshimeve në sistemin tuaj të tretjes për t'ju ndihmuar të humbni peshë. Kirurgjia bariatrike bëhet kur dieta dhe ushtrimet nuk kanë funksionuar ose kur keni probleme serioze shëndetësore për shkak të peshës) është jo e duhur sidomos për adoleshentët me mbipeshë, por të dhënat e saj për sigurinë afatgjata janë të kufizuara në këtë grupmoshë (Aashima Dabas , Anju Seth , 2018).

Vlera e BMI-së së fëmijërisë nuk është një parashikuese e mirë e mbipeshës së të rriturve ose sëmundjes së të rriturve, shumica e të rriturve obezë nuk ishin obezë si fëmijë dhe shumica e sëmundshmërisë së të rriturve të lidhur me mbipeshën, ndodh tek të rriturit që kishin një peshë të shëndetshme gjatë fëmijërisë (Mark Simmonds, Jane Burch, 2015).

3.1. Ndikimi i frekuencave të shujtave ushqimore në shëndet

Përveç konsumit të mëngjesit dhe shpërndarjes së marrjes ditore të energjisë, kufizimit të kalorive dhe ngrënies gjatë natës, gjithashtu duhet të marrim parasysh frekuencën dhe kohën e vaktit. Një rol qendror luan edhe gjatësia e periudhës së “agjërimit” midis dy vakteve. Një model i rregullt i vaktit, duke përfshirë konsumimin e mëngjesit, konsumimin e një pjese më të lartë të energjisë në fillim të ditës, uljen e frekuencës së vaktit (dmth., 2-3 vakte në ditë) dhe periudhat e rregullta të agjërimit mund të ofrojnë përfitime shëndetësore (Paoli, Tinsley, Bianco and Moro, 2019).

Një studim tjetër thotë të dhënat për kohën e vaktit janë përcaktuar si më të mira sesa ato për frekuencën e vaktit (Kahleova, Mashchak, 2017).

Sipas një studimi tjetër nuk ka përfitime shëndetësore për të ngrënë më shpesh. Autori Kris Gunnars ka propozuar një ide për kohën e shujtave: hani kur jeni të uritur, mbaroni kur të ngopeni dhe përsëriteni për një kohë të pacaktuar (Optimal Meal Frequency, 2018).

E rëndësishme është që të ushqehemi shëndetshëm dhe në mënyrë të rregullt, si në aspektin kohor, ashtu edhe në atë cilësor (Gjonbalaj, 2020).

3.2. Zgjedhjet e shëndetshme dhe aktiviteti fizik

Fëmijët dhe të rinjtë e moshës 5-17 vjeç duhet të akumulojnë së paku 60 min. aktivitet fizik me intensitet mesatarë. Ky praktikim përveç përfitimeve shëndetësore fizike, i ndihmon ata edhe lidhur me shëndetin psikologjik. Ngjashëm pjesëmarrja në aktivitete fizike iu ndihmon në zhvillim social duke iu ofruar mundësi në të shprehur, ndërtim vetë-besimi etj. Gjithashtu të rinjtë fizikisht aktiv adoptojnë më shpejtë sjellje shëndetësore (p.sh. shmangia nga duhani, alkooli dhe përdorimi i drogës) (Ewa Szecepanowska et al).

Sipas një studimi të bërë pas një kontrolli për aktivitetin e stërvitjes, pirja e duhanit ishte e lidhur në mënyrë të konsiderueshme me qëndrueshmëri më të ulët fizike, por nuk ishte e lidhur me forcën e përgjithshme të trupit ose përqindjen e dhjavit të trupit (Conway, 1992).

Në një studim tjetër kanë gjetur një lidhje të qëndrueshme dhe negative midis aktivitetit fizik dhe pirjes së duhanit, duke sugjeruar që adoleshentët që marrin pjesë në nivele më të mëdha të aktivitetit fizik kanë më pak të ngjarë të pinë duhan ose të pinë më pak cigare (Audrain-McGovern, 2003).

4. HIPOTEZAT THEMELORE

Në bazë të lëndës dhe problemit të hulumtimit formulohen dhe parashtrohen këto hipoteza:

H₀₁ – Presim që nxënësit të cilët marrin pjesë më shpesh në aktivitete fizike të kenë vlera normale të BMI-së.

H₀₂ – Presim që nxënësit e qytetit të Pejës të jenë më të përfshirë në aktivitete fizike.

H₀₃ – Presim që nxënësit e komunës së Deçanit të kenë vlera më të larta të BMI-së.

5. METODAT E PUNËS

Sipas natyrës së kërkimit shkencor ky studim i përket kategorisë së kërkimeve empirike, ndërsa sipas qëllimit të ndërmarrë paraqet hulumtim aplikativ i cili ka për qëllim të fituarit e njohurive dhe informacioneve të reja të nevojshme për aplikim praktik në fushën e sportit, dhe marr në tërësi, në praktikat pedagogjike në shkolla.

Çdo problem hulumtues është e mundur të studiohet në shumë mënyra të ndryshme. Megjithatë, natyra e shumicës së problemeve dhe karakteristikave të proceseve shpesh kërkojnë një qasje multivariante.

Në lidhje me njohjen e problemit, ky studim paraqet hulumtim konfirmativ ku në bazë të një problemi të njohur kryhet kontrolli i hipotezave të parashtuara duke përdorur metoda të përshtatshme kërkimore.

Në kushtet e përcaktimit kohor, studimi është i karakterit transversal, dhe konsiston në një matjetë vetme të treguesve përkatës të karakteristikave morfologjike, të cilët janë aktiv në sporte përkatëse.

Ky hulumtim shkencor i përket ose bie në kategorinë e hulumtimit shkencor në teren që do të kryhet ose realizohet në kushte natyrore të jetës.

5.1 Mostra e të anketuarve

Nxënësit e anketuar dhe të matur në këtë punim përbëhen nga mostra e definuar si nxënës të moshës 14-15 vjeçar të shkollave fillore “Lidhja e Prizrenit” në Deçan dhe “8 Marsi” në Pejë. Mostra e përgjithshme e punimit do të jetë 200 nxënës, prej të cilëve 100 nga Deçani dhe 100 nga Peja. Nga 100 të testuar nga Deçani 50 do të jenë vajza dhe 50 djem, gjithashtu nga 100 të testuar nga Peja 50 do të jenë vajza dhe 50 djem.

5.2 Mostra e variablave

Si instrument i hulumtimit do të përdoret pyetësi, i modifikuar dhe riformuluar për këtë hulumtim. Pyetësi do të na siguroj të dhëna rreth pjesëmarrjes në aktivitete dhe llojin e tyre, përveç pyetësit, variabla tjera do të jenë pesha dhe lartësia trupore përmes të cilave do nxjerret vlera e indeksit të masës trupore.

5.3 Metodat e përpunimit të rezultateve

Në mënyrë që kërkimi shkencor të jep zgjidhje të kënaqshme, është e nevojshme që të përdoren procedurat e duhura, të drejta dhe komparative e që janë të natyrës së atij problemi të dhënë. Për realizimin e qëllimit të këtij hulumtimi janë zgjedhë procedurat për të cilat konsiderohet se korrespondojnë me natyrën e problemeve që do të hulumtohen.

Për çdo variabël të pyetësit, janë llogaritur vlerat e mëposhtme:

1. Parametrat qëndrorë themelor:

- Mesatarja aritmetikore (Ma),
- Devijimi standard (Ds),
- Vlera minimale (Min),
- Vlera maksimale (Max).

Përmes korelacionit të Spearmanit si metodë për vlerësimin e korelacionit në mes dy variablave do të gjindet lidhmëria në mes aktivitetit fizik dhe vlerave të indeksit të masës trupore.

Nga hapësirat e statistikës komparative (krahasuese) për dy grupe të mostrave të pavarura do të përdoret procedura diskriminative, para së gjithash, analiza parashikuese (t-testi) e cila aplikohet për të shqyrtuar dallimin në mes të gjinive dhe nxënësve të qyteteve të trajtuara në hulumtim.

6. ANALIZA DHE DISKUTIMI I REZULTATEVE

6.1. Interpretimi i parametrave themelor statistikor në bazë gjinie

Në bazë të rezultateve të fituara nga matjet e dy karakteristikave antropometrike, peshës dhe lartësisë trupore, dalim në përfundim se nxënësit nga Peja kanë peshë më të madhe se nxënësit nga Deçani. Dallim më i madh qëndron në mes të gjinisë mashkullore për përafërsisht 4 kg, kurse femrat vetëm për 1 kg.

Qyteti	Gjinia		N	Min	Max	Mean	SD	Skewness		Kurtosis	
Deçan	Mashkull	Pesha	50	45	97	61.80	10.802	1.108	.337	1.808	.662
	Femër	Pesha	50	42	101	56.52	12.564	1.964	.337	4.876	.662
Pejë	Mashkull	Pesha	50	45	93	65.26	10.717	.538	.337	.055	.662
	Femër	Pesha	50	43	70	57.26	6.359	-.191	.337	-.161	.662

Tab.1. Rezultatet për peshën e nxënësve nga të dy komunat dhe për të dy gjinitë.

Dallim më i madh qëndron për lartësinë trupore ku sërish nxënësit meshkuj nga Peja janë më të gjatë se bashkëmoshatarët e tyre nga komuna e Deçanit për 5 cm, njëjtë edhe për gjininë femërore ku sërish nxënëset nga Peja janë më të gjata për 6 cm se nxënëset nga Deçani.

Qyteti	Gjinia		N	Min	Max	Mean	SD	Skeëness		Kurtosis	
Deçan	Mashkull	Lart.trup.	50	1.54	1.87	1.7036	.07227	-.508	.337	.203	.662
	Femër	Lart.trup.	50	1.45	1.87	1.5974	.07401	.917	.337	2.950	.662
Pejë	Mashkull	Lart.trup.	50	1.47	1.94	1.7568	.08448	-.921	.337	1.833	.662
	Femër	Lart.trup.	50	1.50	1.79	1.6536	.05642	-.358	.337	.681	.662


Tab. 2. Rezultatet për lartësinë trupore nga të dy komunat dhe për të dy gjinitë.

III-Merrem me aktivitete rekreative sportive?

Bazuar në jetën e përditshme meshkujt janë më të përfshirë në aktivitetet fizike në përgjithësi, kështu që edhe të testuarit tonë në pyetjen rreth marrjes me aktivitete rekreative-sportive, meshkujt kanë dalë më aktiv se sa femrat. “I/e rregullt (së paku 3 herë në javë)” janë përgjigjur 39% nga meshkujt, ndërsa femrat 29%. “Kohë pas kohe (kryesisht vikendeve) nga 200 të testuar, janë përgjigjur 61% e meshkujve, përqindje e afërt me femrat 63%. Dhe “Asnjëherë” janë përgjigjur 8% femra, ndërsa asnjë mashkull nuk ka dhënë këtë përgjigje.

Gjinia		Frekuenca	Përqindja
Mashkull	I/e rregullt (së paku 3 herë në javë)	39	39.0
	Kohë pas kohe (kryesisht vikendeve)	61	61.0
	Total	100	100.0
Femër	I/e rregullt (së paku 3 herë në javë)	29	29.0
	Kohë pas kohe (kryesisht vikendeve)	63	63.0
	Asnjëherë	8	8.0
	Total	100	100.0

Tab. 3. Niveli i përfshirjes në aktivitete rekreative sportive.




Grafiku 1. Niveli i përfshirjes në aktivitete rekreative sportive.

IV-A jeni pjesëmarrës aktiv në ndonjë sport?

Në bazë të përgjigjive të nxënësve 50% e meshkujve janë pjesëmarrës aktiv në sport, ndërsa pjesa tjetër poashtu 50% nuk janë aktiv në ndonjë sport. Tek femrat numri i atyre që janë aktive është përgjysmë më i vogël se sa numri i meshkujve me 28% ose 28 nga numri total prej 100 femrave dhe 72% nuk janë aktive në ndonjë sport.

Gjinia		Frekuenca	Përqindja
Mashkull	Po	50	50.0
	Jo	50	50.0
	Total	100	100.0
Femër	Po	28	28.0
	Jo	72	72.0
	Total	100	100.0

Tab. 4. Niveli i pjesëmarrjes aktive në sport.




Grafiku 2. Niveli i pjesëmarrjes aktive në sport.

V-Me cilin sport do të merreshit nëse do të kishit mundësi?

Në pyetjen se me cilin sport do të merrreshin nëse do të kishin mundësi, nxënësit kanë dhënë përgjigje jo edhe shumë laramane, mundësi për këtë ka që ata të mos kenë njohuri më të zgjeruara rreth sporteve të ndryshme, mirëpo prapëseprapë kjo mbetet zgjedhja e tyre. Nga 100 meshkuj 16% e tyre kanë thënë që do të merreshin me “Volejbol”, 9% me “Hendboll”, përqindje më e lartë dhe e pritshme kanë dhënë përgjigje “Futboll” prej 38%. Me “Xhudo” 7%, me “Not” nëse do të kishin mundësi do të merreshin 4% prej tyre, përqindje e njëjtë kjo me Ping Pong-un (4%), me Basketboll 13%, për Tenisin 5% dhe Gjimnastikën 4%.

	Meshkujt	Frekuenca	Përqindja
Sportet	Volejbol	16	16.0
	Hendboll	9	9.0
	Futboll	38	38.0
	Xhudo	7	7.0
	Not	4	4.0
	Ping Pong	4	4.0
	Basketboll	13	13.0
	Tenis	5	5.0
	Gjimnastikë	4	4.0
	Total	100	100.0

Tab. 5. Analiza descriptive mbi sportet me të cilat do të merreshin meshkujt.




Grafiku 3. Frekuenca e meshkujve për sportin me të cilin do të merreshin nëse do të kishin mundësi, paraqitur grafikisht.

Nga nxënëset femra kemi gjithsej 6 sporte të cilët I kanë përzgjedhur që nëse do të kishin mundësi do të merreshin me ta. Me “Volejbol” janë përgjigjur 44%, pothuajse gjysma e femrave që kanë marr pjesë në testim, me “Hendboll” do të merreshin 14% nga totali prej 100%, 25% ose ¼ e femrave do të merreshin me Futbollin, përqindje kjo mjaft e lartë duke pas parasysh që futboli nga shumica e shoqërisë konsiderohet si sport i meshkujve. Një përqindje e vogël kanë thënë që do të merreshin me “Ping Pong” prej 2%, “Basketboll” janë përgjigjur 12% e femrave dhe vetëm 3% prej tyre do të merreshin me Gjimnastikën.

Femrat		Frekuenca	Përqindja
Sportet	Volejbol	44	44.0
	Hendboll	14	14.0
	Futboll	25	25.0
	Ping Pong	2	2.0
	Basketboll	12	12.0
	Gjimnastikë	3	3.0
	Total	100	100.0

Tab. 6. Frekuenca dhe përqindja e sporteve që do të merreshin femrat nëse do të kishin mundësi.



Grafiku 4. Frekuenca e nxënëseve femra për sportin me të cilin do të merreshin nëse do të kishin mundësi, paraqitur grafikisht.


VI-Organizimi i aktiviteteve sportive rekreative a është i mjaftueshëm në shkollën tuaj?

Për arsye të ndryshme organizimi i aktiviteteve rekreativo-sportive në shkolla mungon, mirëpo edhe nëse sado pak ka organizime të tilla përfshirja e femrave është më e ulët. Duke u bazuar në përgjigjet e nxënësve 20 meshkuj dhe 27 femra janë përgjigjur që nuk janë të sigurt për mjaftueshmërinë e organizimit të këtyre aktiviteteve. 38 meshkuj dhe 47 femra ishin të pajtimit që organizimi i aktiviteteve rekreative në shkolla është në nivel të duhur. “Jo” kanë menduar 22 meshkuj dhe 6 femra. Ndërsa “Mjaftueshëm” janë përgjigjur nga 20 meshkuj dhe femra.

Në përgjithësi përgjigjet për mjaftueshmërinë e organizimit të aktiviteteve rekreative sportive në shkolla përgjigje pozitive kanë dhënë numër më i madh i femrave, që paraqet një pasqyrë për mospjesëmarrjen e tyre në aktivitetet fizike, duke marr parasysh natyrën e tyre më të qetë dhe jo “garuese”, fitnessit të tyre fizik, poashtu edhe vet interesimi për përfshirjen në aktivitete sportive.

Gjinia		Frekuenca	Percent
Mashkull	Nuk jam i/e sigurt	20	20.0
	Po	38	38.0
	Jo	22	22.0
	Mjaftueshëm	20	20.0
Femër	Nuk jam i/e sigurt	27	27.0
	Po	47	47.0
	Jo	6	6.0
	Mjaftueshëm	20	20.0

Tab. 7. Niveli i mjaftueshmërisë së organizimit të aktiviteteve rekreative sportive në shkolla.



Grafiku 5. Niveli i mjaftueshmërisë së organizimit të aktiviteteve rekreative sportive në shkolla.


VII-A do të dëshironit të humbni peshë dhe të mirëmbani formën trupore?

Në pyetjen për humbje peshe dhe mirëmbajtje trupore me “Po” janë përgjigjur 20% e meshkujve dhe 37% e femrave, përqindje gati dyfish më e madhe se e meshkujve. Hulumtimet kanë treguar që femrat në përgjithësi janë më të shqetësuara për pamjen e jashtme, më pak të kënaqura me trupat e tyre, më shumë të ngjarë të mendojnë se janë më të rënda sesa që janë në të vërtetë, më të prirura për sjellje të çrregullimit të të ngrënit dhe duan të humbin më shumë peshë sesa meshkujt. Këtu duhet marr parasysh edhe moshën e tyre delikate, kur ndodhin ndryshime te shumta fizike dhe psikike, vajzat ngarkohen me peshen e tyre duke menduar që janë të plota dhe nuk janë të vetëdijshme se pesha e tyre trupore varet nga ndertimi morfologjik i trupit.

80% e meshkujve janë përgjigjur negativisht me “Jo” në këtë pyetje, kurse nga 100 femra 63% kanë thënë që nuk duan të humbasin peshë për mirëmbajtjen e formës trupore.

Gjinia		Frekuenca	Përqindja
Mashkull	Po	20	20.0
	Jo	80	80.0
	Total	100	100.0
Femër	Po	37	37.0
	Jo	63	63.0
	Total	100	100.0

Tab. 8. Statistikat deskriptive në lidhje me humbjen e peshës për mirëmbajtjes trupore.




Grafiku 6. Statistikat deskriptive në lidhje me humbjen e peshës për mirëmbajtjes trupore.

VIII-A jeni të informuar për ndikimin e aktivitetit fizik në shëndet?

Rëndësia e aktiviteteve fizike dihet qëështë pazëvendësueshme, filluar nga përmiresimi i pamjes fizike, ndihmon në parandalimin e shumë problemeve shëndetësore që mund të shfaqen në këtë periudhë të jetës dhe sëmundjeve që shfaqen me kalimin e viteve. Mundëson “performancë” të mirë në punë dhe cdoku duke parandaluar lëndimet e ndryshme. Ka rëndësi edhe në aspektin psikologjik e social. 60% e meshkujve dhe 75% e femrave dinë për ndikimin e aktivitetit fizik në shëndet. Nuk kanë njohuri 8% nga meshkujt dhe 4% e femrave. Të informuar mesatarisht janë 25 meshkuj dhe 16 femrat. Dhe njohuri të mjaftueshme kanë 7% dhe 5% e femrave për benefitet e të qenurit aktiv.

Gjinia		Frekuenca	Përqindja
Mashkull	Po	60	60.0
	Jo	8	8.0
	Mesatarisht	25	25.0
	Mjaftueshëm	7	7.0
Femër	Po	75	75.0
	Jo	4	4.0
	Mesatarisht	16	16.0
	Mjaftueshëm	5	5.0

Tab. 9. Statistikat descriptive në lidhje më informimin e ndikimit të aktivitetit fizik në shëndet.




Grafiku 7. Statistikat deskriptive për informimin e ndikimit të aktivitetit fizik në shëndet.

IX-Frekuenca e konsumit të cigareve. Konsumi ditor?

Pirja e duhanit nga të rinjtë dhe adoleshentët është një çështje që prek vendet në të gjithë botën. Shkakton probleme të konsiderueshme shëndetësore, përfshirë rritjen e sëmundjeve të frymëmarrjes, uljen e aftësisë fizike dhe efektet e në rritjen dhe funksionimin e mushkërive. Fatmirësisht rezultatet e pyetësorëve tregojnë shkallë të ulët të konsumit të duhanit. 7% e meshkujve që kanë marr pjesë në plotësismin e pyetësorit konsumojnë “Deri në 10 cigare” brenda ditës, “10-20 cigare” vetëm 1%. “Më tepër se 20 cigare” nuk konsumon askush bazuar në përgjigje dhe “Nuk e konsumojnë” 92% e tyre. 2 femra kanë dhënë përgjigje që konsumojnë “Deri në 10 cigare” brenda dite dhe pjesa tjetër prej 98 kanë deklaruar që “Nuk e konsumojnë” fare duhanin.

Gjinia		Frekuenca	Përqindja
Mashkull	Deri në 10 cigare	7	7.0
	10-20 cigare	1	1.0
	Nuk e konsumoj	92	92.0
	Total	100	100.0
Femër	Deri në 10 cigare	2	2.0
	Nuk e konsumoj	98	98.0
	Total	100	100.0

Tab. 10. Statistikat deskriptive të konsumit të cigareve brenda ditës.




Grafiku 8. Statistikat deskriptive të konsumit të cigareve brenda ditës.

X-Konsumi i alkoolit?

Alkooli ashtu si edhe duhani fillohet në rini dhe trashëgohet për tërë jetën. Ka kalori të mjaftueshme por pak vlera ushqyese, efektet e përdorimit mund të jenë shkatërruese, si pasojat shëndetësore ashtu edhe ikje nga shkolla. Bazuar në përgjigjet e nxënësve “Kohë pas kohe (nganjëherë në javë)” konsumohet nga 3% e meshkujve dhe 2% e femrave, ndërsa nuk konsumohet nga 97% e meshkujve dhe 98% e femrave. “Rregullisht (cdo ditë)” nuk e konsumon askush, as nga meshkujt dhe as nga femrat.

Gjinia		Frekuenca	Përqindja
Mashkull	Kohë pas kohe (nganjëherë në javë)	3	3.0
	Nuk e konsumoj	97	97.0
	Total	100	100.0
Femër	Kohë pas kohe (nganjëherë në javë)	2	2.0
	Nuk e konsumoj	98	98.0
	Total	100	100.0

Tab. 11. Statistikat deskriptive për konsumin e alkoolit.




Grafiku 9. Statistikat deskriptive për konsumin e alkoolit.

XI-Shprehitë në ushqim, shujta ditore?

Në pyetjen sa shujta ose sa herë hanë ushqim brenda një dite janë përgjigjur 3% e meshkujve dhe 3% e femrave. “2 herë” ushqehen 48% e meshkujve dhe 71% e femrave. “3 herë në ditë” 43% e meshkujve dhe 22% e femrave. Dhe “4 herë në ditë” janë përgjigjur një përqindje relativisht e vogël nga të dyja gjinitë, 6% meshkuj dhe 4% femra. Rëndësi ka që të bëhet një “shpërndarje e ushqimit” dhe konsum i ushqimit të llojllojshëm në mënyrë që të sigurohen të gjitha vlerat ushqyese që janë të nevojshme të merren brenda dite.

Gjinia		Frekuenca	Përqindja
Mashkull	1 herë në ditë	3	3.0
	2 herë në ditë	48	48.0
	3 herë në ditë	43	43.0
	4 herë në ditë	6	6.0
	Total	100	100.0
Femër	1 herë në ditë	3	3.0
	2 herë në ditë	71	71.0
	3 herë në ditë	22	22.0
	4 herë në ditë	4	4.0
	Total	100	100.0

Tab. 12. Statistikat descriptive për numrin e shujtave të konsumuara brenda dite.



Grafiku 10. Statistikat deskriptive për numrin e shujtave të konsumuara brenda dite.

XII-Sa orë gjumë bëni?


Relacioni në mes të gjumit dhe mirëqenies në përgjithësi është e mirë-dokumentuar. Gjumi lejon që trupi dhe truri të rikuperohen gjatë natës. Një pushim i natës së mirë siguron që ju do të ndiheni të freskët dhe të gatshëm kur zgjoheni në mëngjes. Zakonisht të rinjtë kanë dëshirë të flenë më gjatë se 8-8.5 orë që janë të mjaftueshme dhe të rekomanduara. Në rastin e kundërt gjumi i pamjaftueshëm mund të shkaktojë lirim të hormoneve që lidhen me obezitetin. Studimet kanë zbuluar se humbja e gjumit mund të rrisë rrezikun tuaj për t’u bërë i trashë. Gjumi ka efekt direkt në funksionimin e rregullt të trurit, në aftësinë e përqendrimit dhe të ruajtjes së memories. Gjumi gjithashtu rrit aftësitë motorike dhe reaksionin.

Nga 100 meshkuj të pyetur për gjumin 12 prej tyre flenë 5—6 orë, 23 flenë 6-7 orë, numër pak më i madh prej 37 meshkujve flenë 7-8 orë, 18 nga 8-9 orë dhe 10 prej tyre flenë 9-10 orë në ditë.

16 femra kanë dhënë përgjigje që flenë 5-6 orë, 25 nga 100 flenë 6-7 orë, 40 flenë nga 7-8 orë në ditë, 13 nga 8-9 orë dhe vetëm 6 femra flenë 9-10 orë në ditë.

Gjinia		Frekuenca	Përqindja
Mashkull	5-6 orë	12	12.0
	6-7 orë	23	23.0
	7-8 orë	37	37.0
	8-9 orë	18	18.0
	9-10 orë	10	10.0
	Total	100	100.0
Femër	5-6 orë	16	16.0
	6-7 orë	25	25.0
	7-8 orë	40	40.0
	8-9 orë	13	13.0
	9-10 orë	6	6.0
	Total	100	100.0

Tab. 13. Statistikat deskriptive në lidhje me orët e kaluara në gjumë.



Grafiku 11. Statistikat deskriptive në lidhje me orët e kaluara në gjumë.


XIII-A jeni person i qetë dhe a e menaxhoni mirë situatën?

Të jesh 5 qetë do të thotë të kontrollosh situatën në të cilën ndodhesh dhe duke vepruar kështu marrim vendime të duhura dhe jo të ngutshme e të pamenduara mirë, e për të cilat më vonë mund të pendohemi. Moshë e adoleshencës është moshë e “vruleve”, mirëpo mekanizmat e mirë të përballimit të stresit dhe ankthit mund t’ju ndihmojnë të qëndroni të shëndetshëm gjatë kohërave të trazuar.

Të rinjët tonë janë përgjigjur në këtë pyetje dhe shumica e tyre janë deklaruar që janë persona të qetë dhe menaxhojnë mirë situatën 58% meshkuj dhe 57% femra. Që nuk janë persona të qetë kanë thënë 5 meshkuj dhe 3% femra. “Ndonjëherë” janë përgjigjur 35% e meshkujve dhe 39% e femrave. Dhe vetëm 1% e femrave është përgjigjur që “Asnjëherë” nuk e menaxhojnë situatën në të cilën ndodhën.

Gjinia		Frekuenca	Përqindja
Mashkull	Po	58	58.0
	Jo	7	7.0
	Ndonjëherë	35	35.0
Femër	Po	57	57.0
	Jo	3	3.0
	Ndonjëherë	39	39.0
	Asnjëherë	1	1.0

Tab. 14. Statistikat descriptive për menaxhimin e situatave.




Grafiku 12. Statistikat deskriptive për menaxhimin e situatave.

XIV-Sa konsumoni ujë gjatë ditës?

“2-4 gota” ujë në ditë konsumohen nga 10% e meshkujve edhe 25% e femrave. “4-5 gota” 25% e meshkujve dhe 18% e femrave. “5-6 gota” ujë konsumohen nga 23% e meshkujve dhe përqindje e njëjtë e femrave poashtu kanë dhënë po këtë përgjigjië. “Më shumë së 6 gota” kanë dhënë përgjigjie 42% e meshkujve dhe 34% e femrave që kanë marr pjesë në plotësimin e pyetësorit.

Gjinia		Frekuenca	Përqindja
Mashkull	2-4 gota	10	10.0
	4-5 gota	25	25.0
	5-6 gota	23	23.0
	Më shumë	42	42.0
	Total	100	100.0
Femër	2-4 gota	25	25.0
	4-5 gota	18	18.0
	5-6 gota	23	23.0
	Më shumë	34	34.0
	Total	100	100.0

Tab. 15. Statistikat deskriptive për sasinë e konsumit të ujit gjatë një ditë



Grafiku 13. Statistikat deskriptive për sasinë e konsumit të ujit gjatë një ditë.


6.2. Interpretimi i parametrave themelor statistikor sipas qytetit

Në pyetjen se sa merren me aktivitete rekreative sportive nga komuna e Deçanit 21 (42%) meshkuj dhe 16 (32%) femra janë të rregullt (së paku 3 herë në javë), 29 ose (58%) meshkuj dhe 31 (62%) femra janë aktive “Kohë pas kohe (kryesisht vikendeve)”. Dhe “Asnjëherë” nuk janë aktive vetëm 3 (6%) femra.

Nga komuna e Pejës 18 (36%) meshkuj dhe 13 (26%) femra janë aktive së paku 3 herë në javë. “Kohë pas kohe (kryesisht vikendeve) janë aktiv njëjtë 32 (64%) meshkuj dhe femra. Nuk janë aktive “Asnjëherë” 5 (10%) femra. Meshkuj që nuk janë aktiv nuk ka në asnjërën nga komunat.

Qyteti	Gjinia		Frekuenca	Përqindja
Deçan	Mashkull	I/e rregullt (së paku 3 herë në javë)	21	42.0
		Kohë pas kohe (kryesisht vikendeve)	29	58.0
	Femër	I/e rregullt (së paku 3 herë në javë)	16	32.0
		Kohë pas kohe (kryesisht vikendeve)	31	62.0
		Asnjëherë	3	6.0
Pejë	Mashkull	I/e rregullt (së paku 3 herë në javë)	18	36.0
		Kohë pas kohe (kryesisht vikendeve)	32	64.0
	Femër	I/e rregullt (së paku 3 herë në javë)	13	26.0
		Kohë pas kohe (kryesisht vikendeve)	32	64.0
		Asnjëherë	5	10.0

Tab. 16. Pjesëmarrja e të rinjëve në aktivitete rekreative sportive nëdy komunat.



Grafiku 14. Pjesëmarrja e të rinjëve në aktivitete rekreative sportive nëdy komunat.


IV-A jeni pjesëmarrës aktiv në ndonjë sport?

Në të qenit aktiv në ndonjë sport rezultati është pak i habitshëm, duke marr parasysh nivelin e zhvillimit të infrastructures së ndryshme të dy qyteteve. Megjithatë në rezultatet tona nga Deçani kemi 30 (60%) të meshkujve aktiv në klube sportive, ndërsa pjesa tjetër prej 20 meshkujve (40%) nuk janë aktiv. Tek femrat numri i atyre që janë aktive është 15 (30%), kurse i atyre që nuk janë aktive në ndonjë sport është 35 (70%).

Në qytetin e Pejës kemi rezultat të ndryshëm sa i përket gjinisë mashkullore, përqindje e njëjtë vetëm se dallon raporti i përgjigjive “Po” dhe “Jo” me 20 (40%) aktiv dhe 30 (60%) joaktiv. Ndërsa tek gjinia femërore kemi pothuajse të dy komunat kanë përqindje të përafërt, me 13 (26%) aktive dhe 37 (74%) inactive nga totali i 100 femrave që kanë marr pjesë në mostër të hulumtimit.

Qyteti	Gjinia		Frekuenca	Përqindja
Deçan	Mashkull	Po	30	60.0
		Jo	20	40.0
	Femër	Po	15	30.0
		Jo	35	70.0
Pejë	Mashkull	Po	20	40.0
		Jo	30	60.0
	Femër	Po	13	26.0
		Jo	37	74.0

Tab. 17. Pjesëmarrja aktive në sport e të rinjëve në dy komunat.



Grafiku 15. Pjesëmarrja aktive në sport e të rinjëve në dy komunat.

V-Me cilin sport do të merreshit nëse do të kishit mundësi?

Nga numri total i nxënësve meshkuj nga Deçani vetëm 7 (14%) do të merreshin me Volejball, 1 (2%) prej tyre me Hendboll, numri më i madh prej 22 ose 44% do të merreshin më Futbollin, 1 me Notin, 4 (8%) nëse do të kishin mundësi do të luanin Ping Pong, me Basketboll janë përgjigjur 9 (18%) dhe me Tenis dhe Gjymnastikë nga 3 (6%) e meshkujve.


Sporti më i preferuar për femrat e komunës së Deçanit është Volejboli, për të cilin janë përgjigjur 20 (40%), me vetëm 6 (12%) do të merreshin me Hendboll, numër mjaft i lartë kanë dhënë përgjigje për Futbollin prej 16 (32%), ndërsa sportet tjera janë deklaruar numër më i vogël, për Ping Pong 2 (4%), Basketbollin dhe Gjymnastikën nga 3 (6%) e femrave për secilin nga të dy sportet.

Në qytetin e Pejës me Volejball do të merreshin 9 (18%) meshkuj dhe 24 (48%) femra, me Hendbollin 8 (16%) meshkuj dhe 8 (16%) femra, me Futboll 16 (32%) meshkuj dhe 9 (18%) femra, me Xhudo 7 (14%) meshkuj dhe asnjë femër, me Not 3 (6%) meshkuj dhe asnjë femër, me Basketboll 4 (8%) meshkuj dhe 9 (18%) femra, me sportin e Tenisit 2 (4%) dhe vetëm 1 (2%) me Gjymnastikën meshkuj dhe asnjë femër.

Përqindja më e madhe e meshkujve janë përgjigj për sportin e Futbollit, ndërsa tek femrat Volejboli është sporti më i preferuar edhe pse Futbolli nuk qëndron shumë larg këtij të fundit (sa i përket komunës së Deçanit, sepse në atë të Pejës ka dallime ndërmjet këtyre dy sporteve). Kjo mund të jetë një fillim i ndryshimit të botëkuptimit rreth sporteve të cilët ndahen në sportet për meshkuj dhe sportet për femra. Kjo mund të shërbejë edhe si tregues për mungesën e klubeve sportive, por jo në të gjitha rastet.

Qyteti	Gjinia	Frekuenca	Përqindja	
Deçan	Mashkull	Volejball	7	14.0
		Hendboll	1	2.0
		Futboll	22	44.0
		Not	1	2.0
		Ping Pong	4	8.0
		Basketboll	9	18.0
		Tenis	3	6.0
		Gjimnastikë	3	6.0
	Femër	Volejball	20	40.0
		Hendboll	6	12.0
		Futboll	16	32.0
		Ping Pong	2	4.0
		Basketboll	3	6.0
		Gjimnastikë	3	6.0
Pejë	Mashkull	Volejball	9	18.0
		Hendboll	8	16.0
		Futboll	16	32.0
		Xhudo	7	14.0
		Not	3	6.0
		Basketboll	4	8.0
		Tenis	2	4.0
		Gjimnastikë	1	2.0
	Femër	Volejball	24	48.0
		Hendboll	8	16.0
		Futboll	9	18.0
		Basketboll	9	18.0

Tab. 18. Sportet me të cilat do të merreshin të rinjtë e dy komunave.



Grafiku 16. Sportet me të cilat do të merreshin të rinjtë e dy komunave.

VI-Organizimi i aktiviteteve rekreative sportive a është i mjaftueshëm në shkollën tuaj


Në të mjaftuarit e organizimit të aktiviteteve rekreativo-sportive në shkollën e tyre, nxënësit e Deçanit janë përgjigjur kështu: “Nuk jam i/e sigurt” 9 meshkuj dhe 11 femra, “Po” 24 meshkuj dhe 26 femra. “Jo” 5 meshkuj dhe 2 femra, “Mjaftueshëm” 12 meshkuj dhe 11 femra.

Në komunën e Pejës nxënësit kanë dhënë këto përgjigje: “Nuk janë të sigurtë” për organizimin e aktiviteteve shtesë në shkollën e tyre 11 meshkuj dhe 16 femra nga totali prej 100 nxënësve, “Po” kanë menduar 14 meshkuj dhe 21 femra, “Jo” 17 meshkuj dhe 4 femra dhe me “Mjaftueshëm” janë përgjigj 8 meshkuj dhe 9 femra.

